

**PROCESVERBAL**  
**nga seanca e 13-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime**  
**Mediatike Audio dhe Audiovizuale**  
**mbajtur më 2.4.2026**

**Anëtarët e Këshillit të Agjencisë të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë:** mr. Sasho Stefanovski, mr. Zirjeta Jajaga, mr. Gordana Majnova, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, Petar Xhurovski dhe Viktor Pavlovski.

**Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /**

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr.Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

**Të punësuar nga shërbimi profesional të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë:** dr.Ivana Stojanovska, Cvetanka Mitrevska, Maja Damevska, Sergej Todorovski.

**Të pranishmit e tjerë: /**

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi seancën e 13-të të Këshillit. Seanca filloi në orën 18:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si vijon:

**RENDIN E DITËS**

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit të seancës së 12-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 30.3.2026.
2. Propozim – vendim për pagesën e kompensimit për ndërprerjen e punës për daljen në pension të punonjësi.
3. Të ndryshme.

**Pika 1**

Këshilli shqyrtoi dhe njëzëri miratoi procesverbalin e propozuar të seancës së 12-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 30.3.2026, me tekstin e propozuar.

**Pika 2**

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajçevski, shpjegoi propozim-vendimin për pagesën e kompensimit për ndërprerje të kontratës së punës në bazë të daljes në pension të punonjësi. Ai shpjegoi se punonjësi i Agjencisë, i punësuar përmes Agjencisë për punësim të përkohshëm, më 5 prill të vitit aktual i plotëson kushtet ligjore për realizimin e të drejtës së pensionit. Në përputhje me Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, Ligjin për marrëdhënie pune dhe aktet nënligjore të Agjencisë, propozohet t'i paguhet kompensim për ndërprerje të kontratës së punës në shumën prej dy pagave mesatare mujore-neto në RMV-së.

Këshilltarja mr. Gordana Majnova, kërkoi shpjegim më të detajuar në lidhje me materialet e paraqitura sipas pikës. Ajo tregoi se, sipas tyre, punëtori i përkohshëm ishte angazhuar përmes Agjencisë për punësim të përkohshëm në periudhën nga 1.4.2025 deri më 1.4.2026. Ajo theksoi se përmes Sektorit për financa dhe logjistikë të Agjencisë, ishte kërkuar zgjatje e angazhimit edhe për dy ditë, me shumë mundësi deri në përmbushjen e kërkesës ligjore për pension, përkatësisht deri në mbushjen e moshës 64 vjeç. Ajo pyeti nëse punonjësi ishte angazhuar në ASHMA vetëm gjatë periudhës së caktuar apo kishte angazhman më parë. Përveç kësaj, ajo pyeti nëse punonjësit i ishte paguar pushimi vjetor (K-15) gjatë vitit të kaluar, bazuar në cilat kritere dhe nëse dispozitat e Rregullores së punës për pagën bruto dhe kompensim të tjera të Agjencisë zbatohen edhe në lidhje me pagesën e kompensimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës.

Drejtori i Agjencisë, Trajçevski, sqaroi se punonjësi është angazhuar që nga shkurti i vitit të kaluar dhe se nuk i është paguar K-15. Ai shpjegoi më tej se në rastin e angazhimit përmes Agjencisë për punësim të përkohshëm nuk kryhet procedurë e shpalljes publike, por kryhet zgjatje e kontratës. Ai theksoi se, përveç punonjësit në fjalë, kontratat u janë zgjatur edhe punonjësve të tjerë të angazhuar në Agjenci, të vendosur në Sektorin për çështje juridike dhe furnizime publike, Sektorin për çështje programore dhe Sektorin për mbështetje informative dhe çështje të përgjithshme.

Këshilltarja Majnova pyeti pse këtij punonjësi gjatë vitit të kaluar nuk i ishte paguar regres për pushim vjetor (K-15).

Drejtori Trajçevski sqaroi se praktika e mëparshme në Agjenci është që personat e angazhuar përmes Agjencisë për punësim të përkohshëm të mos u paguhet K-15.

Këshilltarja Majnova, në drejtim të sqarimeve shtesë, ngriti çështjen e zbatueshmërisë së të drejtës për regres për lejen vjetore (K-15), e cila rrjedh nga Ligji për marrëdhënie të punës dhe Rregulloren për pagën bruto dhe kompensimet e tjera të Agjencisë, përkatësisht nëse e njëjta i referohet edhe personave të angazhuar përmes një Agjencie të Punësimit të Përkohshëm.

Në përgjigje të kësaj pyetjeje, drejtori Trajçevski theksoi se informacione më të sakta në lidhje me pagesën e K-15 mund të ofrohen shtesë, pas përfundimit të seancës.

Njëkohësisht, Këshilltarja Majnova theksoi se pyetja e shtruar buron nga fakti se në shpjegimin e Vendimit, Agjencia i referohet të drejtave të përcaktuara nga Ligji për marrëdhëniet e punës dhe Ligjit të Agjencive private të punësimit.

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike, Cvetanka Mitrevska, shpjegoi se, siç thuhet në shpjegimin e Vendimit, në nenin 19 të Ligjit të Agjencive private të punësimit, për pesonat e caktuar përmes Agjencisë për punësim të përkohshëm vlejné të njëjtat dispozita ligjore në fushën e marrëdhënieve të punës. Kjo do të thotë se Ligji për

marrëdhëniet e punës zbatohet edhe për këta persona. Përveç kësaj, ajo theksoi se, siç e kishte shpjeguar tashmë dhe drejtori, praktika e mëparshme në Agjenci ishte që këtyre personave të mos u paguhej regres për pushim vjetor (K-15), por se pas konsultimeve të kryera me drejtorin u vendos që të hiqet kjo praktikë, përkatësisht nga viti 2026, dhe personave të angazhuar përmes Agjencisë për punësim të përkohshëm do të fillojnë të marrin gjithashtu K-15. Së fundmi, ajo theksoi se këta persona gëzojnë të njëjtat të drejta të përcaktuara në Rregulloren për pagën bruto dhe kompensime të tjera.

Këshilltarja Majnova, bazuar në shpjegim, konstatuan se nëse punonjësi i takon e drejta për rekurs për lejen vjetore (K-15), atëherë ai ka të drejtë edhe për pagesë për ndërprerje të punësimit, por nëse K-15 nuk i paguhet, nuk është e qartë pse tani i njihet e drejta për pagesë për ndërprerje të punësimit.

Drejtori Trajçevski sqaroi se pagesa e kompensimit për ndërprerje të kontratës së punës nuk është detyrim absolut, por varet nga mundësitë financiare të Agjencisë. Në rastin konkret, duke marrë parasysh që Agjencia ka burime financiare për këtë qëllim, propozohet që punonjësit të lartpërmendur t'i paguhet kompensim për ndërprerje të kontratës së punës.

Kryetari Stefanovski vuri në dukje se, sipas shpjegimit, praktika e mëparshme e Agjencisë ka qenë që personave të angazhuar përmes Agjencisë për punësim të përkohshëm të mos u paguhet regres për pushim vjetor. Megjithatë, ai theksoi se nga viti 2026, sipas diskutimeve me menaxhmentin, është planifikuar të fillojë pagesa e këtij kompensimi edhe këtyre personave.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Kërkesën e paraqitur nga punonjësi nr. 05-1636/1 datë 2.4.2026 për pagesën e kompensimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës si dhe Kërkesën nga Sektori për financa dhe logjistikë, nr.04-1622/1 datë 1.4.2026 dhe me 5 vota "pro" dhe dy "abstenime" nga mr. Gordana Majnova dhe Afrona Vërzivolli, dha miratimin që drejtori i Agjencisë të miratojë Vendim për miratimin e mjeteve financiare në shumën prej dy pagave mesatare mujore-neto mujore në RMV-së, përkatësisht 92.978,00 denarë si kompensim për ndërprerje të kontratës së punës pas daljes në pension të punëtorit të përkohshëm të agjencisë Billage Miloshevski, i angazhuar në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) përmes Agjencisë private për punësim "EGZEKJUTIV SRÇ LIZING" Shkup, në vendin e punës kujdestar në Njësinë e punës materiale dhe logjistikë pranë Sektorit për financa dhe logjistikë, me të cilën Agjencia ka lidhur Kontratë për furnizim publik nr.0307/2-11/2026 datë 1.4.2026 (nr. ynë ark.03-1599/1 datë 1.4.2026).

Mjetet financiare në shumë prej 92.978,00 denarë janë siguruar me Planin Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2026.

Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit, ndërsa pagesa e mjeteve financiare do të kryhet pas përbushjes së kushteve ligjore për dalje në pension, përkatësisht me mbushjen e moshës 64 vjeç dhe 15 vjet stazh pune për pension.

Pas votimit, Kryetari i Këshillit Stefanovski e uroi punonjësin me rastin e pensionimit dhe i dëshiroi ditë të gjata dhe të këndshme pensioni.

**Pika 3**

**Të ndryshme**

Nuk kishte diskutim nën "Të ndryshme".

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
m.r Sasho Stefanovski**

Përktheu: Antoneta Shabani